



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR
TË GJIMNAZIT**

FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE

LËNDA: GJEOGRAFI

KODI: 8.3.12.Z

PROGRAMI I LËNDËS SË GJEOGRAFISË

PËR KLASËN E 12^{të}

TIRANË, PRILL 2010

Programi i lëndës “Gjeografia e problemeve globale” për klasën e 12^{-të} të gjimnazit trajton çështje të ndryshme ekonomike, sociale, politike dhe mjedisore botërore në këndvështrimin global. Ky program ngrihet mbi domosdoshmërinë e përgatitjes së nxënësve si qytetarë aktivë që të përballen e të mirëmenaxhojnë sfidat e së sotmes dhe të së ardhmes. Nxënësit përdorin njohuritë, mjetet dhe metodat e gjeografisë për të shqyrtuar këto çështje dhe për të sugjeruar rrugë të zgjidhjes së problemeve që lidhen me zhvillimin e ekonomisë, industrisë, bujqësisë, tregtisë, popullsisë, urbanizimit, diversitetin kulturor, etj.

Me fokus dimensionin hapësinor të zhvillimeve globale, lënda synon t’i orientojë nxënësit drejt një “gjeografie çështjesh dhe problematikash” (ndërshtetërore, rajonale, globale). Duke qenë se lënda “Gjeografia e problemeve globale” është lëndë me zgjedhje, programi mundëson për nxënësit hapësira përfshirjeje e thellimi në fushat që ai dëshiron e ka interes dhe të cilat, në njëfarë mënyre, përbëjnë disa ndër sfidat më të mëdha që ne si shoqëri e shekullit të 21 do të përballojmë: “Si do t’i përgjigjet shoqëria sfidës së ngrohjes globale? Si do të zgjidhen dhe parandalohen konfliktet gjeopolitike? Si mund t’i përdorim në mënyrë sa më efektive burimet natyrore të kufizuara? Si mund t’i projektojmë qytetet për të qenë të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore dhe për një cilësi më të mirë të jetës? e të tjera si këto.

Lënda gjithashtu krijon mundësi eksplorimi ndaj tendencave të reja të globalizmit dhe multikulturalizmit, si dhe mundësinë e konceptimit të raportit midis tyre. Në tërësi, programi krijon hapësira për studimin e elementëve të gjeografisë fizike, por veçanërisht asaj humane. Dukuritë humane ndihmojnë në formimin e kulturës së përgjithshme të nxënësve, sidomos në kuptimin dhe pranimin e ngjashmërive dhe të ndryshimeve ndërmjet popujve, shteteve dhe rajoneve të ndryshme evropiane dhe botërore.

Grumbullimi dhe përpunimi i fakteve, shifrave e të dhënave të ndryshme gjeografike, demografike, kulturore, ekonomike, etj, përmes metodave statistikore dhe prezantimi grafik i tyre, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i lëndës Gjeografia e problemeve globale synon që nxënës/i-ja:

- të fitojë njohuri mbi natyrën e ndërvarur të proceseve globale ekonomike, sociale, politike, demografike, mjedisore;
- të zhvillojë aftësi në kërkimin gjeografik, vendimmarrje dhe komunikim;
- të parashikojë tendencat e këtyre zhvillimeve në nivel lokal, rajonal apo botëror.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi, nxënës/i, -ja:

- të japë mendimin e tij/saj për mundësitë dhe sfidat e ndërvarësisë globale;
- të përshkruajë modelet hapësinore të zhvillimeve demografike, ekonomike, kulturore, sociale e mjedisore dhe tendencat e këtij zhvillimi në nivel lokal, rajonal apo botëror;

- të kuptojë konceptet themelore, të cilat bëjnë të mundur kërkimin në mënyrë të pavarur, si dhe të përdorë njohuritë për çështjet shoqërore;
- të zhvillojë aftësinë për të përdorur burime të ndryshme të informacionit, si dhe të mbajë një qëndrim kritik për to;
- të përdorë dhe të organizojë të dhënat e ndryshme që përftohen nga mjetet e informacionit, për të kuptuar më mirë dukuritë dhe proceset gjeografike;
- të përdorë shprehjet praktike në ndërtimin e grafikëve, diagrameve, skicave, matjeve dhe lokalizimeve në hartë, etj;
- të demonstrojë aftësitë e komunikimit, të menduarit kritik dhe krijues, të zgjidhjes së problemeve;
- të demonstrojë qëndrime etiko-sociale gjatë punës në grup dhe si individ.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

Linja: Sistemet humane

Përshkrim i linjës: Kjo linjë zhvillon aftësitë e të menduarit kritik rreth ndërveprimit të sistemeve kulturore, ekonomike, politike, mjedisore dhe teknologjike dhe pasojave të tij në nivel global. Nxënësit përdorin perspektivën hapësinore për trajtimin e një sërë problemeve bashkëkohore, të tilla si: rritja e popullsisë, urbanizimi me ritme marramendëse, diversiteti kulturor, degradimi mjedisor, globalizimi i ekonomisë, etj.

Orë të sugjeruara¹: 53 orë

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit) që të shtojë ose pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10 % sipas nevojave të klasës.

Bloku tematik	Objektiva
Dinamikat e problemeve të popullsisë	<p>Në përfundim të klasës së 12^{te}, nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë objektin e studimit të kësaj lënde, lidhjet e saj me degët e tjera të gjeografisë si dhe me shkencat e përfaqësuara; - të përshkruajë projeksionet e popullsisë, kontrollin dhe perspektivën e shtimit natyror të popullsisë në botë; - të analizojë tranzicionin demografik në vendet në zhvillim; - të analizojë ecurinë e të dhënave të mbledhura dhe të paraqitura grafikisht të disa modeleve tipike demografike botërore; - të realizojë një detyrë tematike përmes së cilës të debatojë

	<p>mbi dinamikën e popullsisë në Kinë dhe kontrollin e saj nga politikat;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë statet e migracionit të brendshëm nga zonat rurale drejt zonave urbane, shoqëruar me raste studimorë; - të evidentojë disa ndër strategjitë për uljen e migracionit nga zonat rurale drejt zonave urbane; - të analizojë shkaqet e migracionit të jashtëm dhe pasojat e tij përmes rasteve studimorë nga vende të ndryshme; - të prezantojë historikun e emigrimit të shqiptarëve në botë përmes të dhënave të shfrytëzuara nga burime të ndryshme informacioni; - të realizojë në grup një projekt kërkimor mbi migracionin e brendshëm në Shqipëri, karakteristikat, shkaqet, pasojat dhe strategjitë për menaxhimin e tij; - të përcaktojë shpërndarjen hapësinore të gjuhëve më të përhapura sot në botë dhe veçoritë e tyre të zhvillimit; - të përshkruajë disa ndër politikat për mbijetesën e gjuhëve të minorancave; - të zhvillojë një detyrë kërkimore mbi përhapjen e gjuhëve indoevropiane, problematika që lidhen me to, përmes hulumtimit në burime të ndryshme informacioni (materiale burimore, Internet, media, etj); - të tregojë shpërndarjen hapësinore të problemeve etnike më të spikatura përmes rasteve studimorë (si p.sh. problemet etnike në Ballkan; baskët në Spanjë; tibetianët; etj), shkaqet dhe problemet që i shoqërojnë; - të vlerësojë disa ndër politikat dhe perspektivat e zgjidhjes së konflikteve etnike; - të tregojë shpërndarjen hapësinore të besimeve fetare më të përhapura sot; - të analizojë disa ndër problematikat më të spikatura fetare, pasojat e tyre; - të tregojë shpërndarjen hapësinore të grupeve racore në botë dhe disa ndër problematikat kryesore që i shoqërojnë.
	<ul style="list-style-type: none"> - të përkufizojë zhvillimin; - të tregojë përmasat dhe modelet e zhvillimit në botë, treguesit ekonomikë, socialë dhe demografikë të tij; - të analizojë faktorët që ndikojnë në nivelin e zhvillimit ekonomik të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim, shoqëruar me shembuj; - të përshkruajë mobilitetin (lëvizshmërinë) e aktiviteteve të ekonomisë moderne sot, faktorët që ndikojnë si dhe

<p>Ekonomia globale dhe problematikat shoqëruese të saj</p>	<p>pasojat e kësaj lëvizshmërie;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë bashkëpunimet shumëkombëshe (si. p.sh. Toyota, General Electric, etj) si mjet suksesi në treg; - të zhvillojë një detyrë tematike duke sjellë argumente që mbështesin alternativën e zgjedhur: "Ekonomia evropiane, diverse apo komplementare?"; - të përshkruajë klasifikimin e aktiviteteve ekonomike, sektorin primar, sekondar, terciar dhe tiparet e zhvillimit global; - të realizojë një projekt mbi tipologjinë, parimet dhe modelet e zhvillimeve globale; - të evidentojë tipologjinë e rajoneve bujqësore në botë sot, shoqëruar me shembuj; - të përshkruajë veçoritë e revolucionit të gjelbër dhe pasojat e tij në zhvillimin e vendeve ku është zhvilluar; - të identifikojë modelet e industrisë botërore dhe tendencat e zhvillimit të saj në ditët e sotme; - të përshkruajë pasojat e zhvillimeve industriale dhe revolucionin teknologjik (fazat, ndryshimet sot); - të analizojë natyrën globale të tregtisë (ndërvarësinë e ekonomisë botërore sot) dhe rëndësinë e këtij sektori shoqëruar me studime rasti; - të interpretojë rolin e organizmave ndërkombëtarë si OBT, BE, G8, NAFTA, OPEC, etj, dhe politikat e tyre në tregtinë botërore; - të zhvillojë në grup një projekt mbi globalizimin e tregtisë, avantazhet dhe disavantazhet që shoqërojnë këtë proces; - të identifikojë karakteristikat e zhvillimit të rrjetit botëror - të transporteve sot, shoqëruar me shembuj; - të debatojë mbi “konfliktin” midis zhvillimit të rrjetit të transporteve përkundrejt mjedisit dhe strategjitë për menaxhimin e tij; - të përshkruajë zhvillimin e telekomunikacionit sot dhe tiparet e zhvillimit, shoqëruar me shembuj.
<p>Tiparet dhe problematikat e zhvillimit urban</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë sistemet dhe strukturat urbane; - të përshkruajë origjinën dhe rrënjët e urbanizimit; - të evidentojë veçoritë e funksionimit dhe zhvillimit të qyteteve në botë, natyrën e qyteteve dhe funksionet e tyre; - të përshkruajë strukturimin e zonave urbane, modelet urbane dhe diversitetin urban botëror; - të përshkruajë veçoritë e funksionimit dhe zhvillimit të megaqyteteve në botë;

	<ul style="list-style-type: none"> - të realizojë në grup një projekt kërkimor mbi veçoritë e urbanizimit të një territori në nivel lokal/rajon/global; - të krahasojë, përmes shembujve, modele të ndarjes administrative dhe të decentralizimit të qeverisjes; - të përshkruajë veçoritë e ndarjes administrative në Shqipëri dhe problemet që janë evidentuar; - të zhvillojë një detyrë tematike mbi historikun e hierarkisë së ndarjeve administrative në Shqipëri shoqëruar me zhvillimet e fundit.
Zhvillimet gjeopolitike të botës së sotme	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale gjeopolitike botërore; - të tregojë ndryshimet e hartës politike të botës (dekolonizimin) deri në Luftën e Dytë Botërore dhe evolucionin e saj pas Luftës së Dytë Botërore; - të analizojë krijimin e shteteve të rinj pas rënies së murit të Berlinit (kushtet, faktorët), problematikat që kanë shoqëruar zhvillimin e tyre, shoqëruar me shembuj; - të realizojë një detyrë tematike me temë: "Kufijtë që ndryshuan Evropën".
Çështje sociale, problematikat dhe gjeografia e tyre	<ul style="list-style-type: none"> - të tregojë shpërndarjen gjeografike të varfërisë si dhe faktorët që ndikojnë në këtë shpërndarje (të ndalë në faktorët humanë, të tillë si niveli i mirëqënies, papunësia, pabarazia, etj); - të debatojë mbi perspektivën e kësaj problematike duke evidentuar rrugë të mundshme të zbutjes së saj.

Linja: Ndërveprimi njeri-mjedis

Përshkrim i linjës: Përmes kësaj linje, nxënësi/ja kupton pasojat e ndërveprimeve midis sistemeve fizike dhe humane, diskuton pro-të dhe kundër-të politikave të veçanta dhe të programeve për përdorimin e burimeve dhe menaxhimin e tyre.

Orë të sugjeruara: 15 orë

Bloku tematik	Objektiva
	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë përdorimin e burimeve të ripërtërishme

<p style="text-align: center;">Sfidat e mëdha të shekullit XXI</p>	<p>të energjisë sot në botë (energjinë e erës, diellit, ujit, biomasën, energjinë atomike) shoqëruar me shembuj, duke veçuar vendet tipike të shfrytëzimit të secilës;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të evidentojë rreziqet natyrore dhe kontrollin e burimeve për zhvillim; - të vlerësojë rolin e aktivitetit human dhe ndikimin e tij në mjedis; - të analizojë shkaqet dhe pasojat e ngrohjes globale; - të vlerësojë politikat botërore për ngrohjen globale; - të realizojë një detyrë tematike mbi klimën dhe ngrohjen globale duke shfrytëzuar të dhëna dhe fakte të mbledhura përmes burimeve të ndryshme të informacionit; - të analizojë rajonet më të ndotura sot në botë, shkaqet dhe pasojat e tyre në zhvillimin botëror; - të debatojë mbi politikat botërore për reduktimin e ndotjes; - të krijojë p.sh. një album apo CD, video, me foto, komente për ndotjen në një territor të caktuar, pasojat dhe rrugët e reduktimit të saj; - të analizojë faktorët që ndikojnë në prishjen e ekuilibrit në ekosisteme të rëndësishme (p.sh. shpyllëzimet në Indonezi, pellgun e Amazonës, etj) si dhe pasojat për mjedisin; - të realizojë në grup ose në mënyrë individuale një projekt me temë "Bota përballë katastrofave natyrore"; - të identifikojë shkaqet dhe pasojat e përmbajtjeve të shumta sot në botë, shoqëruar me shembuj; - të diskutojë mbi rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve dhe kujdesit për shtretërit e lumenjve; - të vlerësojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përmes koordinimit të politikave globale të zhvillimit; - të tregojë rrugë dhe strategji drejt një zhvillimi të qëndrueshëm industrial, bujqësor dhe urban; - të përgatisë një ese argumentuese mbi konfliktin "zhvillim" dhe "mjedis", dhe rrugët për menaxhimin e tij.
---	---

4. KËRKESA TË LËNDËS GJEOGRAFIA E PROBLEMEVE GLOBALE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjeografia e problemeve globale	Gjeografia rajonale
- Për të gjithë blloqet	Nxënës/i, -ja:

tematikë	<ul style="list-style-type: none"> - të analizojë kuptimin e konceptit rajon sipas kriterëve të rajonizimit; - të përzgjedhë në informacionin e ofruar për rajone të ndryshme, specifikat e zhvillimit ekonomik e social të rajoneve si dhe vendndodhjen gjeografike të tyre.
Gjeografia e problemeve globale	Matematika
<ul style="list-style-type: none"> - Temat lidhur me lëvizjet demografike, zhvillimi i ekonomisë. 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të mbledhë, përpunojë dhe interpretojë të dhënat statistikore matematikisht dhe grafikisht (tabela, grafikë, diagrame, etj).
Gjeografia e problemeve globale	Qytetaria
<ul style="list-style-type: none"> - Bllloqet tematikë që lidhen me mozaikun kulturor të popujve si dhe çështjet sociale. 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përkufizojë kulturën dhe elementët e saj; - të përcaktojë bashkëpunimin, konfliktin dhe analizojë rrugët e zgjidhjes së tij; - të japë kuptimin e tij/saj për konceptet shtet, komb, kombësi, etni, demokraci, globalizëm.
Gjeografia e problemeve globale	Ekonomia
<ul style="list-style-type: none"> - Ekonomia globale 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë konceptet ekonomi tregu, bashkim ekonomik, bashkim doganor, integrim, papunësi, inflacion, GDP, indeksi i zhvillimit human, shoqëri shumëkombëshe.
Gjeografia e problemeve globale	Gjuha shqipe
<ul style="list-style-type: none"> - Për të gjithë bllloqet tematikë 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit; - të shprehë opinione; - të përgatisë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese; - të përzgjedhë informacionin e duhur në një vëllim të caktuar; - të shfrytëzojë teknikat e duhura gjuhësore, për të shkruar një detyrë tematike.
Gjeografia e problemeve globale	TIK
<ul style="list-style-type: none"> - Në punët praktike, punën me projekte, në një pjesë 	<p>Nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të njohë programet bazë (Word, Power Point, Exel,

të madhe temash.	<p>etj), që i duhen për përgatitjen dhe prezantimin e punëve të pavarura dhe me projekte;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të ndërtojë grafikë dhe tabela; - të kërkojë në Internet (të dhëna, informacion, harta tematike, fizike, imazhe satelitore, etj).
------------------	--

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Gjeografia e problemeve globale, si lëndë me zgjedhje të detyruar, në klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit do të zhvillohet me 2 orë mësimore në javë. Gjatë vitit shkollor do të zhvillohen gjithsej: **34 javë x 2 orë = 68 orë mësimore.**

Në mënyrë që programi i kësaj lënde të zbatohet më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tij duhet të njohin thellë programet bërthamë të lëndës së gjeografisë për klasën e 11-të dhe të 12-të.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të nxënë ç'ka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektiveve në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Orët mësimore

Programi i Gjeografisë së problemeve globale për klasën e dymbëdhjetë është ndërtuar në dy linja të cilat janë strukturuar në blloqe tematikë që vijnë njëri pas tjetrit dhe që ndjekin një renditje të caktuar e cila jo domosdoshmërisht duhet të ndjekë të njëjtën ecure (renditje) gjatë vitit shkollor.

Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë, ndërsa ndarja e orëve sipas blloqeve tematike mbetet në lirinë e mësuesit. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektiveve të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm. E rëndësishme është të mos ndryshojë totali i orëve mësimore që kjo lëndë ka në dispozicion.

Programi i lëndës **Gjeografia e problemeve globale** realizohet në 68 orë mësimore vjetore, prej të cilave afërsisht **60%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e **njohurive të reja lëndore** dhe **40%** e tyre janë për **përpunimin e njohurive** (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Shembujt

Përdoruesit e programit duhet të synojnë shpjegimin e dukurive gjeografike përmes përdorimit të shembujve apo rasteve studimore të cilët janë të nevojshëm dhe të vlefshëm për ilustrimin e çështjeve.

Kërkimi gjeografik

Kërkimi gjeografik është komponent i rëndësishëm i kësaj lënde që u siguron mundësi nxënësve të realizojnë zbatimin praktik të aftësive gjeografike. Nxënësit duhet të përdorin një gjerësi burimesh informacioni, përfshirë burimet e shtypura (enciklopedi, materiale informues, statistika, atlase, etj), median, internetin si bazë hetimi vetjak, për argumentimin e një problematike të caktuar. Përveç kësaj, kërkimi gjeografik i inkurajon nxënësit të zhvillojnë qëndrime bazuar në argumente, duke parashikuar perspektivat e zhvillimit të një problematike të caktuar, parë gjithmonë në këndvështrimin gjeografik.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive-bazë;
- Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Përsëritjen vjetore (Pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësive të përgjithshme të komunikimit, menaxhimit të informacionit, zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- Aftësive të posaçme lëndore si puna me hartën, projektet kurrikulare;
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Mësuesi mund të përdorë metoda të cilat janë të efektshme për të krijuar aftësi dhe qëndrime gjatë përpunimit të njohurive të tilla si:

- Diskutimi në klasë (*p.sh. nxënësit diskutojnë duke argumentuar zgjedhjen e tyre për tematikën "Ekonomia evropiane, diverse apo komplementare?"*);
- Diskutimi në grupe (*p.sh. klasa ndahet në dy grupe të cilat debatojnë mbi politikat globale të reduktimit të ndotjes: njëri grup vihet në rolin e vendeve shkaktare të ndotjes dhe grupi tjetër në rolin e vendeve që nuk ndikojnë në shtimin e ndotjes por që pësojnë të njëjtat pasoja*);
- Projektet në grup apo individualë (*p.sh. nxënësit realizojnë një projekt individual mbi vendin e ekonomisë evropiane në ekonominë botërore, veçoritë, rolin e saj, tendencat e zhvillimit ose (zhvillojnë në grup një projekt mbi globalizimin e tregtisë, avantazhet dhe disavantazhet që shoqërojnë këtë proces*);
- Ese –ja (*p.sh. përgatisin një ese argumentuese mbi konfliktin "zhvillim" dhe "mjedis" dhe rrugët për menaxhimin e tij*);
- Etj.

Metoda që përdor mësuesi, nuk mund të jetë me rendimentin e duhur pa mbështetjen e mjeteve didaktike, ku vendin kryesor e zënë hartat e llojeve e shkallëve të ndryshme, atlase, globe, skica, grafikë, etj. Kur përdoren hartat, tablotë dhe mjetet e tjera

të konkretizimit, mësuesi duhet të përpiket vazhdimisht të formojë te nxënësi aftësitë e nevojshme për lokalizimin e objekteve dhe të dukurive të veçanta gjeografike.

Kjo lëndë siguron mundësi që nxënësit të zhvillojnë disa teknika matematikore, veçanërisht ato të shoqëruara me vlerësimin dhe manipulimin e të dhënave (*si p.sh. nxënësit analizojnë ecurinë e të dhënave të mbledhura dhe të paraqitura grafikisht të disa modeleve tipike demografike botërore*). Gjithashtu ato kanë mundësi të përdorin teknologjinë, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me përdorimin e pajisjeve dhe kompjuterët.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe përforcuar konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

6. VLERËSIMI

Realizimi i përshkallëzuar i programit kërkon zgjedhjen e formave dhe të teknikave bashkëkohore të vlerësimit për të kontrolluar shkallën e përvetësimit të dijeve të nxënësve. Tashmë përsosja e këtyre teknikave ka çuar në verifikimin më objektiv të përgatitjes, ndjekjen hap pas hapi të ecurisë së përparimit të nxënësve, shtimin e kontrolleve përmes ndërtimit të testeve, zgjidhjeve të detyrave, ushtrimeve, punës me hartën, punëve praktike etj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, me shkrim ose me gojë, në klasë ose jashtë saj. ***Nxënësi vlerësohet:***

- *Nëse demonstroi përvetësimin e dijeve të marra dhe arritjet e tij, me gojë ose me shkrim.* Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Herë pas here, mësuesi duhet të vlerësojë me notë duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.
- *Nga interpretimi i drejtë i hartave, grafikëve, skicave etj.* Interpretimi i tyre, ndihmon në mënjanimin e mangësive që mund të kenë ata në përvetësimin e çështjeve, njohurive (koncepteve etj.) dhe veprimtarive të veçanta. Interpretimi, gjithashtu, nxit interesat intelektuale të nxënësve dhe edukon tek ata, ndjenjën e punës.
- *Gjatë orëve të diskutimit apo debatit.* Në këtë rast tematika i bëhet e njohur që më parë në mënyrë që ai të ketë grumbulluar informacion e argumente bindës.
- *Nëse ka përgatitur në grup ose individualisht: një poster, fletëpalosje e album sensibilizues apo qëndrimi aktiv për zgjidhje të problematikave të ndryshme.* P.sh. për mjedisin, emigrimin, bashkëpunim e mirëkuptim fetar apo etnik, etj.
- *Në një ese të përgatitur, në lidhje me problematika të ndryshme.* Ese-të mund të jenë të ndryshme, por më me interes për klasën, do të ishte argumentuese ose vlerësuese. Kjo sepse, nxënësi mëson dhe kupton mbi bazën e argumenteve, si dhe nxitet tek ai, qëndrimi e vendimmarrja individuale.

- Nëse ka përgatitur në grup ose individualisht punë të pavarura, detyra tematike dhe projekte. Gjatë vlerësimit mësuesi/ja, vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësi, aftësinë e tij për të diskutuar, debatuar, krahasuar, forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme. Mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup.

Në punën me projekte në grupe nxënësish, mësuesi/ja bën kujdes për vlerësimin e kontributit të grupit si dhe kontributit individual të secilit nxënës.

Çfarë mund të vlerësojë mësuesi/ja?

- Cilësinë e punimit: shkallën e realizimit të objektivave të vëna.
- Shkallën e bashkëpunimit në grup dhe mënyrën e ndarjes së përgjegjësive: secili mund t'i bëjë të ditur klasës se çfarë kontributi ka pasur ai në grup.
- Performancën e ndërtimit dhe të paraqitjes së materialit: mënyrën si e kanë konceptuar e paraqitur dhe si e prezantojnë atë.
- Shkallën e krijimit të njohurive dhe të dijeve të qëndrueshme: (pasi shpesh nxënësit e kuptojnë këtë vetëm si grumbullim të materialeve dhe jo përpunim e asimilim të tyre).

Mësuesi/ja nxit e ndihmon nxënësit (përmes përgatitjes së fishave të vlerësimit), që edhe ata vetë të mund të vlerësojnë njëri-tjetrin por edhe të vetëvlerësohen, sidomos në realizimin e punëve në grup apo projekteve.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit dhe arritjeve të nxënësve në këtë fushë. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.